


Vitin e kaluar 2014 aeroporti i Shkupit “Aleksandri i Madh”, për herë të parë arriti 1 milion pasagjerë në 10 muajt e parë, ndërsa vitin e përfundoi me një numër total prej 1,2 milion pasagjerë, një rritje prej 23,2% në krahasim me vitin 2013. Destinacioni me frekuencë më të lartë është Stambolli (“Ataturk” dhe “Sabiha Gokçen”), me pjesë tregu 15,7 %, dhe më pas vijën Viena, Ciriku, Bazel- Milhaus, Malme, Londra-Luton dhe Beogradi. Sipas shteteve, vendet e para me fluturime direkte janë Turqia (17,25% pjesë tregu), Gjermania (14,46 %), Zvicra (13,75%), Suedia (11,52%), Austri (8,2%) dhe Italia (7,6%).

Numri i lëvizjeve totale të avionëve vitin e kaluar u rrit në 16,3%, në 13,147 fluturime gjithsej, ku “Erbas 320” është modeli më i zakonshëm i avionëve, me 46,3% pjesëmarrje në fluturime komerciale. Sipas pjesëmarrjes në trafikun e pasagjerëve , “Vizer”, e cila ka kosto më të ulët, vitin e kaluar transportoi numrin më të madh të pasagjerëve me pjesë tregu 46,3 %, dhe pas saj qëndrojnë “Turkish erlajns”, “Austrian erlajns”, “Er Serbia”, “Pegasus erlajns” dhe “Edelweiss”.

Në aeroportin e Shkupit viti i kaluar ka qënë i rëndësishëm edhe për kargo trafikun, i cili pësoi një rritje të konsiderueshme prej 33% në volumin e përgjigjshëm, ose nga 2,686 tonë në vitin 2013, vitin e kaluar me avion janë transportuar mallra me peshë prej 3.580 tonë. Në pesë vitet e fundit, kargo-trafiku i përgjithshëm në të dy aeroportet në Maqedoni pësoi një rritje prej 57%.

Numri i pasagjerëve në aeroportin e Shkupit “Aleksandri i Madh” (2010-2014)



Numri i përgjithshëm i pasagjerëve në të dy aeroportet – “Aleksandri i Madh” i Shkupit dhe “Shën. Apostull Pavli” i Ohrit. (2010-2014)

